



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.80

Prishtinë, më 20.2.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Sërgjan Popoviq dhe Mufera Shinik.

Përfaqësues të ftuar:

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i proceverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.2.2017;**
- 3. Diskutim lidhur me gjendjen në Arsimit e Lartë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.2.2017;

Anëtarët e Komisionit miratuan pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 13.2.2017.

3. Diskutim lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë;

Nait Hasani hapi mbledhjen e Komisionit, ku u diskutua për gjendjen në Arsimin e Lartë, për të cilin ishte i ftuar edhe ministri i MASHT-it, i cili për arsye të agjendës nuk mundi të marrë pjesë. Ai tha se gjendja në Arsimin e Lartë është mjaftë e rëndë, duke theksuar edhe problemet me akreditimin, cilësinë si dhe elemente të tjera të rëndësishme. Ai theksoi se është bërë një punë e mirë, sa i përket infrastrukturës në përgjithësi, të cilën e vlerësoi si të mirë.

Më tej, ai shtoi se në takimin me Kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin, janë pajtuar që bashkërisht të angazhohen për përmirësimin e gjendjes edhe në fushën e Inspektoratit, për të cilën tha se planifikojnë të realizojnë vizita studimore në vendet e rajonit për të marrë praktikat më të mira në këtë fushë.

Hasani propozoi që të ftohen rektorët e universiteteve, për të diskutuar për gjendjen në Universitetet që ata i udhëheqin. Ai po ashtu propozoi që edhe kryetari i Agjencisë së Akreditimit të ftohet për raportim në Komision, në mënyrë që të diskutohet në lidhje me akreditimin e disa programeve në disa fakultete. Ai tha se duhet të rregullohet fusha e arsimit, se ka mospërputhje të statuteve të universiteteve me Ligjin për Arsimin e Lartë.

Teuta Haxhiu në fjalën e saj kërkoi që anëtarëve të komisionit t'u sillen materialet e diskutimit me ish- ministrin e MASHT-it, Rexhep Osmani, në mënyrë që të njihen për së afërmi me të gjeturat që ai paraqiti në takimin që kanë pasur së bashku në Komision. Ajo kërkoi që të sillen sa më parë Ligji për Arsimin e Lartë dhe me të të rregullohen shumë çështje të fushës së arsimit si dhe nevoja e harmonizimit të statuteve të universiteteve publike me Ligjin për Arsimin e Lartë. Më tej, ajo tha se e mbështet idenë që të ftohen të gjithë rektorët e universiteteve publike si dhe kryetari i Agjencisë për Akreditim, me qëllim që të diskutohen të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen ata dhe gjetjen e zgjidhjes së këtyre problemeve.

Shukrije Bytyçi paraqiti shqetësimin e kolegëve të saj, të cilët sipas saj janë të detyruar për të kryer nivelin e studimeve Master në Fakultetin e Edukimit, në mënyrë që ata të mund të konkurrojnë në pozitë e mësimdhënësve. Ajo tha se ky fakultet është shndërruar në monopol. Një shqetësim tjetër ishte mungesa e objektivit për Fakultetin e Shkencave Natyrore. Më tej, ajo shtoi se ka shkelje procedurash dhe kriteresh me rastin e angazhimit të stafit akademik, ku ka raste që asistentët zgjidhen në kundërshtim me ligjin dhe kriteret e parapara. Ajo propozoi po ashtu që të ftohen rektorët e universiteteve publike si dhe përfaqësuesit e kolegjeve private për të diskutuar për këto zhvillime dhe për Ligjin e Arsimit të Lartë.

Bytyçi shtoi se mbi 600 pedagogëve u është mohuar e drejta që të jenë mësues klasorë dhe se kjo çështje duhet ngritur në diskutimet e ardhshme të Komisionit dhe për këtë çështje ajo fajësoi të gjithë ministrat për arsim që kanë qenë deri më tani. Ajo theksoi se pavarësisht që Qeveria ka premtuar që arsimit dhe shkenca do të jetë me prioritet kombëtar, buxheti për shkencë është i pamjaftueshëm dhe si rrjedhojë kërkoi që ky buxhet të rritet.

Ismajl Kurteshi veçoi disa çështje në lidhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. Ai tha se kolegjet private nuk po i respektojnë afatet e regjistrimit të studentëve si dhe planifikimi i pushimeve dimërore nuk po bëhet konform më atë që zbatohet në institucionet publike.

Një shqetësim tjetër i ngritur kishte të bënte siç e quajti ai, diskriminimin herë pozitiv e herë negativ të disa studentëve dhe tha se ka marrë shqetësimin e 4 studenteve të cilave u është bërë e padrejtë dhe u është mohuar e drejta e regjistrimit në nivelin Master në Fakultetin Ekonomik, dhe se kjo ka ndodhur pavarësisht që ato kanë kaluar provimin pranues.

Në vijim, tha se duhet të diskutohet vendimi i datës 2 qershor 2015 i UP-së, ku në pikën 3, stafi akademik në marrëdhënie të rregullt pune, sipas nevojës për angazhim shtesë mund të angazhohet edhe për një normë të plotë mësimore. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Konflikt Interesi, ku ligji parasheh një normë të plotë dhe 50% shtesë.

Në diskutimin e tij, foli edhe për të gjeturat e Organizatës për rritjen e cilësisë në arsim, ku sipas tij janë gjetur shkelje procedurash dhe mosplotësim kriteresh akademike për titujt akademikë të 61 profesorëve akademikë të Universitetit të Prishtinës. Ai po ashtu e mbështeti propozimin që të ftohen të gjithë rektorët e universiteteve publike për të diskutuar për Arsimin e Lartë.

Shpejtim Bulliqi në diskutimin e tij ngriti disa çështje, duke shtuar se nuk duhet parë gjithçka vetëm zi në arsimin e lartë, duke kujtuar se është i vetëdijshëm për mangësitë dhe problemet që ka kjo fushë. Ai përmendi Fakultetin e Edukimit, duke thënë se me këtë fakultet janë bërë eksperimente që një kohë të gjatë. Më tej ai shtoi se është absurde që atyre studentëve të cilët mëtojnë të bëhen arsimtarë apo mësues klasor, t'u kërkohet që përveç studimeve të profilit që ata kanë ndjekur për një periudhë të caktuar, të ndjekin edhe dy vite Master në Fakultetin e Edukimit.

Në vazhdim të fjalës së tij, Bulliqi foli edhe për Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, që sipas tij ka ndër marrë një ministër i papërgjegjshëm, i cili ka pasur për qëllim të rehatojë vetën dhe kolegët e tij për të mbajtur mësim në Universitetin Publik. Ai prezantoi disa nga kriteret bazë që duhet plotësuar për t'u zgjedhur staf akademik, siç janë nota mesatare, disertacioni i doktoratës etj.

Një shqetësim tjetër kishte të bënte më sistemin dylëndorë, ku shtoi se në vend që mësimdhënësit të shkojnë të studentët, këta të fundit të cilët janë të interesuar të kryejnë mësimdhënien, në një formë obligohen të shkojnë tek profesori në Fakultetin e Edukimit. Ai tha se për këtë ky fakultet nuk e ka asnjë kuadro. Për këtë Kosova ka marrë primatin e riprodhimit të kuadrove, të cilët më pastaj nuk kanë vazhdimësi në studimet e tyre në kuptimin e fushës së studimeve. Ata pastaj po ligjërojnë në kolegjet private, po bëjnë një përvojë dhe më pas po konkurrojnë në UP, duke thënë se janë afro 140 të tillë që kanë kaluar këtë proces.

Më tej foli për titujt akademikë dhe tha se ka lëshime evidente, por që nuk janë në atë shkallë sa po paraqiten në opinion dhe që një OJQ të merret me këtë. Ai tha se për këtë, UP-ja i ka institucionet e veta, të cilat e vlerësojnë dhe duhet të mbikëqyrin këtë proces.

Një çështje tjetër e ngritur pati të bëjë me mungesën e objektit të Fakultetit të Shkencave Matematikore-Natyrore, i cili është i vetmi institucion që nuk ka objektin e vet dhe që vepron me qira. Ai tha se kjo është një domosdoshmëri dhe kërkoi që të gjenden format që të realizohet ky projekt, duke theksuar se Qeveria nuk e ka përkrahur financiarisht ndërtimin e këtij objekti.

Sa i përket akreditimit, tha se ky është një problem në vete sepse fakultetet po bëjnë një grumbull të drejtimeve, të cilat janë të njëjta dhe theksoi nevojën e orientimit në drejtimet që ai i quajti deficitare.

Bekim Haxhiu në fjalën e tij, tha ky diskutim duhet të zhvillohet edhe me aktorë të tjerë të cilët do të mund të jepnin kontributin dhe përvojat e tyre në fushën e Arsimit të Lartë, sipas rregullores së Kuvendit dhe të Komisionit. Ai shtoi se ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë është i domosdoshëm ngase me ligjin aktual, rregullimi i nivelit të arsimit, është 3 deri 4 vjet studime, studenti arrin 180 kredi respektivisht 240, për ato drejtime që kanë 4 vjet studime. Shqetësimi i tij pati të bëjë më njohjen e studimeve për studentët që kanë përfunduar studimet në 5 dhe 6 vjeçare dhe kjo sipas tij, me këtë ligj do të ishte joligjore. Si rrjedhojë e kësaj, duhet të behët riorganizimi i Fakultetit të Mjekësisë dhe të shndërrohet në Universitet të Shkencave Mjekësore. Ai tha se problemi kryesor qëndron në licencimin e programeve dhe nuk është menduar për studentët se çka dhe ku do të shkojnë ata. Ai tha se këto mangësi të Ligjit për Arsimin e Lartë mund të evitohen me ndryshimet statutore të universiteteve publike. Për këtë çështje, ai tha se duhet të takohen me rektorët e universiteteve për të diskutuar dhe harmonizuar statutet e universiteteve më ligjin. Ai shtoi se tek angazhimi i stafit akademik, këto statute janë në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe Kushtetutën e Kosovës.

Ai gjithashtu theksoi nevojën e miratimit të Ligjit për Inspektoratin dhe organizimi i tij në mënyrë që gjitha parregullsitë dhe ankesat të trajtohen dhe adresohen në mënyrë më të mirë. Digjitalizimi i provimit për profesionet e rregulluara do të rriste cilësinë dhe në këtë mënyrë do të nxiste rritjen e cilësisë edhe tek kolegjet private krahas atyre publike.

Ai foli edhe për raportin e Organizatës për rritjen e cilësisë në arsim, duke thënë se këto raporte po hartohen nga studentë të cilët ende nuk kanë përfunduar studimet e tyre dhe se kjo organizatë është derivat i partive politike dhe më pastaj e një organizate studentore.

Në fund të fjalës së tij, ai propozoi që të ftohen edhe përfaqësuesit e institucioneve private, pasi që sipas tij edhe ata po prodhojnë kuadro dhe po interferojnë në cilësinë e arsimit në vend.

Salih Morina tha se Komisioni ka bërë një punë të mirë dhe se ka realizuar vizita dhe takime me aktorë të fushës së arsimit me të cilët janë dakorduar për bashkëpunim edhe më të madh sa i përket rritjes së cilësisë në arsim. Ai vuri theksin tek nevoja e monitorimit të ligjeve që kanë të bëjnë me arsimin.

Morina foli edhe për problemin e mosnjohjes së diplomave të studentëve të Fakultetit të Edukimit, të cilët kanë përfunduar studimet në programe të cilat nuk kanë qenë të akredituara. Krejt në fund, ai tha se duhet që bashkërisht të angazhohemi për implementimin e rekomandimeve të dala nga harmonizimi në grupet parlamentare si dhe të ligjeve e udhëzimeve administrative të Ministrisë.

Ismajl Kurteshi tha se sa i përket cilësisë në kolegjet private, ajo nuk është e kënaqshme, dhe në këtë mënyrë ne si institucione duhet t'i detyrojmë që të rrisin cilësinë.

Çështja tjetër që ai ngriti, ishte që të gjeturat e raportit të Organizatës për rritjen e cilësisë në arsim të mos hedhen poshtë por të verifikohen dhe se kjo organizatë nuk merret me vlerësim por me statistika.

Bekim Haxhiu tha se vlerësimi i disa kolegjeve private njëjtë me ato publike e sjell nevojën e riorganizimit të institucioneve publike në nivelin që ato të jenë universitete.

Por një shqetësim i Haxhiut pati të bënte me vlerësimin e cilësisë së këtyre institucioneve, kur janë profesorët që ligjërojnë në universitetet publike ata të cilët po ligjërojnë edhe në ato private. Sa i përket transparencës së universiteteve, Haxhiu tha se UP-ja ka dhënë një shembull të mirë, kur ka publikuar dosjen e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për tituj akademikë.

Shukrije Bytyci tha se Ligji për Arsimin e Lartë duhet të silllet sa më shpejt në Kuvend pasi që ka nevojë për harmonizim të statuteve të universiteteve publike. Ndërkaq, sa i përket përzgjedhjes se stafit akademik, ajo tha se ka shkelje të kriterëve. Më tej, ajo tregoi për një rast të mohimit të drejtës për angazhimin e një ligjëruesi, i cili i ka plotësuar kriteret, por që është angazhuar vetëm një semestër kurse në semestrin vijues ai është larguar. Ajo propozoi që edhe Ligji për Inspektoratin të diskutohet sa më parë në Komision.

Teuta Haxhiu tha se nuk ka universitete private e as kolegje universitare, pasi që ato nuk janë të akredituara si të tilla. Haxhiu kërkoi që të sillen vendimet e Agjencisë për Akreditim për mbylljen e disa kolegjeve private, të cilat pas pak ditësh janë hapur dhe studentët kanë vijuar studimet si dhe të kërkohet llogari pse kjo ka ndodhur.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhje të veçanta të ftohen rektorët e universiteteve publike si dhe të atyre të bartësve privatë të arsimit të lartë.

4. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E Përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani